

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-060-AL	06.05.2020	0	0	1 / 8

Neni 1

Dispozita e përgjithshme

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë marrjen e masave higjeno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë dhe covid – 19 në institucionin tonë, gjithashtu ka për qëllim të orientojë dhe t'u rekomandojë studentëve dhe stafit praktikantët e duhura të kufizimit të përhapjes së COVID-19 duke siguruar mos transmetimin e infeksionit midis stafit dhe studentëve për krijimin e një ambienti pune të shëndetshëm.

Objektivi i masave të përfshira në këtë rregullore është të minimizojnë riskun për infektimin nga COVID-19, përmes praktikave të distancimit fizik dhe dezinfektimit.

Për të gjitha rastet kur është e domosdoshme të kryhet aktiviteti akademik me prani fizike të studentëve duhen zbatuar masat e parashikuara në këtë rregullore.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore mbështetet në urdhërin nr.289, datë 4/05/2020 “Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj Covid – 19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”, urdhërin nr.105, datë 24/02/2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për marrjen e masave higjeno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë dhe covid – 19 në institucionet parashkollore, kopshte dhe çerdhe dhe institucione të tjera arsimore”, Ligjin. Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Statutin e Kolegjit Universitar “Bedër”.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit

Kolegji Universitar “Bedër”:

1. Siguron kushte të përshtatshme higjeno –sanitare duke përdorur solucione pastruese dhe dizinfektuese në ambientet e tij.
2. Siguron higjenën personale të studentëve sipas udhëzimeve të shëndetit publik.
3. Siguron higjenën personale të stafit akademik, administrativ dhe stafit mbështetës të institucionit.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-060-AL	06.05.2020	0	0	2 / 8

4. Sguron edukimin e vazhduar të studentëve dhe stafit në lidhje me masat e higjënës personale sipas udhëzimeve të shëndetit publik.
5. Mjeku i institucionit mbledh nga njësitë përgjegjëse numrin e mungesave për arsye shëndetësore.
6. Kolegji Universitar “Bedër” është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshëm të mjeteve të mbrojtjes personale si maska dhe doreza (maskat mund të jenë dhe prej cope dhe të ndërrohen çdo ditë.) Institucioni siguron përdorimin e maskave dhe dorezave si barrierë fizike për minimizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19.

Neni 4

Shmangia e rasteve të dyshuara

Studentët me shenja të sëmundjes (<https://infocoronavirus2019.al/simptomat/>) këshillohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të informojnë zyrën e sekretarisë mësimore përmes telefonit. Zyra e Sekretarisë Mësimore informon dekanatin e fakultetit përkatës për çdo rast të evidentuar.

Institucioni duhet të ketë një mjedis të caktuar të izoluar për një staf ose student, i cili mund të shfaqë shenja klinike të sëmundjes dhe më pas lajmërohet 127-ta dhe NJVKSH-ja (Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor) përkatëse dhe ISHP (Instituti i Shëndetit Publik).

Neni 5

Hyrja dhe dalja nga ambientet e institucionit

1. Studentët hyjnë në instituconin arsimor pasi janë vendosur në rradhë një nga një, me largësi 1.5 deri 2 metra.
2. Lejohet të hyjnë në institucion vetëm studentët të cilëve u është miratuar kërkesa nga organet kompetente duke paraqitur një mjet identifikues para oficerit të sigurisë.
3. Studenti që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në institucionin arsimor, njofton personin përgjegjës për çeshtjet shëndetësore, i cili, në bashkëpunim me mjekun e institucionit arsimor ose atë të familjes,verifikon nëse student i është sëmurë apo jo.
4. Personi përgjegjës i institucionit arsimor ,i caktuar nga drejtuesi i institucionit arsimor, duhet të kryejë procedurën për çdo student si më poshtë vijon:
 - a. Matje të temperaturës me termometër digjital;
 - b. Sprucim me alkool 60% ose dizifektantë të tjerë në duar;

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-060-AL	06.05.2020	0	0	3 / 8

- c. Duhet të kontrollohen të gjithë studentët që të jenë të pajisur me maskë njëpërdorimshe ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili(maskë)të cilat duhet të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen,si dhe shami letre për higjenën e hundëve.
- Nuk lejohet që studentët të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të ,brenda ditës.
 - Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje në ndërtesën e instituteucionit arsimor.
 - Studentët që nuk zbatojnë këtë rregullore, trajtohen me masë disiplinore nga Komisioni i Etikës dhe i Sjelljes.

Neni 6

Qëndrimi në auditore

Brenda auditorit studentët qëndrojnë të ulur në banka të paktën 1.5 deri në 2 metër larg njëri tjetrit.Nëse numri i studentëve është më i madh se sa hapësira e klasës që do të duhej për të respektuar këtë kusht, mësimi zhvillohet në më shumë se një grup apo klasë. Gjatë procesit mësimor, pedagogu qëndron në klasë duke respektuar distancimin social dhe fizik me studentët dhe pedagogët e tjerë, në 1.5 deri në 2 metër.

Pedagogët sigurohen që në auditor të gjithë të jenë të paisur me maskë dhe ti mbajnë rregullisht ato. Nu lejohet ushqimi në auditor.

Neni 7

Lëvizjet në mjediset e brendshme të institucionit

- Lëvizja e studentëve në salla, laboratorë, dhe nëpër korridore duhet bërë duke ruajtur distancën 1.5 deri në 2 metër, duhet të përdorin boksen e tyre duke mos u takuar asnjë moment me studentët e klasave të tjera.
- Ndalohet përdorimi i ashensorit nga më shumë se një individ në të njëjtën kohë.
- Nuk lejohen qëndrimet në korridore.
- Nuk do të përdoren materiale të printuara përveç rasteve kur studentët kanë libra të cilat i mbajnë tek sendet materiale, ose në shtëpi.
- Do të shmangen kontaktet fizike me personat që mund të jenë të pranishëm në ambientet e institucionit.
- Ashensori mund të përdoret vetëm nga një individ në të njëjtën kohë.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-060-AL	06.05.2020	0	0	4 / 8

Neni 8

Kujdesi për Higjenën

1. Çdo student duhet të lajë duart ose të përdorë dizinfektant pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prëkja e hundës, suve gojës ose pas heqjes së maskës dhe dorezave etj.
2. Dritaret duhen të mbahen të hapura ose të paktën auditoret/sallat, laboratorët, zyrat, biblioteka të ajrosen 5-6 herë gjatë kohës së mësimin.
3. Kolegji Universitar “Bedër” siguron matjen e temperaturës të studentëve dhe stafit në hyrje të institucionit me qëllim evidentimin e individëve që mbartin shenjat e covid-19 dhe parandalimin e përhapjes së virusit në fjalë.
4. Gjatë qëndrimit në institucion çdo individ duhet të mbajë detyrimisht maskë.
5. Institucioni duhet të vendosë postera që inkurajojnë higjenën e duarve për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes në hyrje të vendit të punës dhe në zona të tjera të vendit të punës ku janë të dukshme.
6. Institucioni siguron që distanca e tavolinave të punës për stafin brenda zyrës do të jetë minimumi 2 m larg nga njëra tjetra.
7. Aktivitet jashtëshkollorë, sportive e artistike në grup janë të ndaluara.
8. Duhet të sigurohen: uji i rrjedhshëm, sapuni i lëngshëm, letra për fshirjen e duarve dhe solucionet me përmbajtje alkoli 60%.
9. Institucioni siguron pastrimin dhe dizinfektimin e nyjeve hidrosanitare, bokseve, koridoreve, bibliotekës, auditoreve dhe ambienteve të përbashkëta me një nga mënyrat e pastrimit të mjedisit të parashikuar në nenin 11 të kësaj rregulloreje. Përgjegjës për monitorimin e procesit të pastrimit dhe dizinfektimit është zyra e çështjeve administrative. Pas pastrimit dhe dizinfektimit të auditorëve nuk mund të zhvillohet mësim pa kaluar 60 minuta.
10. Janë të ndaluara takimet dhe mbledhjet ballë për ballë në ambientet e institucionit
11. Në hyrje dhe në dalje të ambienteve të institucionit rekomandohet të vendoset një higjenzues për duart në trjatë solucionet me përmbajtje aktive të alkolit 60%, i cili duhet të jetë gjatë gjithë kohës i pranishëm.
12. Do të pranohen në ambientet e institucionit vetëm studentët që pranojnë të nënshkruajnë këtë rregullore. Studentët që nuk zbatojnë këtë rregullore do të

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-060-AL	06.05.2020	0	0	5 / 8

ndëshkohen me masë disiplinore referuar rregullores respektive të Kolegjit Universitar “Bedër”.

13. Është e detyrueshme që të mos përdoret shtrëngimi i duarve dhe përqaftimet midis punonjësve dhe të inkurajojë përdorimin e metodave të tjera jokontaktuese të përshëndetjes.
14. Punonjësit nuk duhet të përdorin mjetet e njëri- tjetrit dhe postet e ndërsjellta të punës.
15. Stafi dhe studentët duhet të respektojnë praktikat e etikës respiratore, kollitjes e teshtitjes duke përdorur vënien e gropëzës së brrylit përpara gojës dhe hundës.
16. Duhet të praktikuar pastrimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve dhe elementëve të tjerë të vendit të punës si psh. Si tavolinat e punës, tastierat, telefonat, parmakët dhe dorezat. Është e nevojshme që produktet dezinfektante të kenë përqindjen, metodën e aplikimit dhe kohën e kontaktit të saktë, si dhe përdorimi i tyre duhet bërë duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale.
17. Stafi nuk duhet të përdorë telefonat, tavolinat, zyrat ose mjetet dhe pajisjet e punëtorëve të tjerë, kur është e mundur. Nëse është e nevojshme, të pastrohen dhe dezinfektohen ato para dhe pas përdorimit. Gjithashtu duhet të sigurohen pastruesit e mundshëm në mënyrë që sipërfaqet e përdorura zakonisht (për shembull tavolinat, tastierat mjetet dhe pajisjet e tjera të punës etj.) mund të fshihen nga punonjësit para çdo përdorimi.

Neni 9

Personeli ndihmës

1. Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orait të punës maskën, dorezat dhe solucione dizinfektuese.
2. Korridorët pastrohen çdo 2 orë.
3. Bokset pastrohen e dizinfektohen çdo 30 minuta.
4. Ashensori duhet të pastrohet e dizinfektohet çdo 30 minuta.
5. Dorezat e çdo auditori/salle dhe mjedisi pune si dhe parmakët e shkallëve pastrohen dhe dizinfektohen çdo 30 minuta.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

**RREGULLORE MBI MARRJEN E MASAVE HIGJENO-SANITARE
PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONEVE
RESPIRATORE AKUTE PËRFSHIRË DHE COVID – 19**

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-060-AL	06.05.2020	0	0	6 / 8

Neni 10**Oficeri i Sigurisë**

1. Oficeri i Sigurisë të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dizinfektuese.
2. Oficeri i Sigurisë nuk lejon prezencën e asnjë individi në institucion përveç studentëve dhe stafit të institucionit.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

**RREGULLORE MBI MARRJEN E MASAVE HIGJENO-SANITARE
PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONEVE
RESPIRATORE AKUTE PËRFSHIRË DHE COVID – 19**

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-060-AL	06.05.2020	0	0	7 / 8

Neni 11

Mënyrat e pastrimit të mjedisit

Për shkak të mbijetesës së mundshme të virusit në mjedis për disa ditë, ambientet dhe zonat e kontaminuara potencialisht me covid-2019 duhet të pastrohen para ripërdorimit të tyre duke përdorur produkte që përmbajnë agjentë antimikrobikë të njohur si efektiv kundër koronavirusëve. Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar agjentët antimikrobikë efektiv kundër koronavirusëve të ndryshëm.

Agjenti antimikrobial	Përqëndrimi	Koronaviruset e testuar	Referenca
Etanol	70%	HCoV-229E, MHV-2, MHV-N, CCV, TGEV	(4,6,7)
Hipoklorit Natriumi	0.1-0.5%, 0.05-0.1%	HCoV-229E, SARS-CoV	6
Povidone-Jodine	10% (1% Jodine)	HCoV-229E	5
Glutaraldehide	2%	HCoV-229E	6
Izopropanol	50%	MHV-2, MHV-N, CCV	6
Klorid Benzalkonium	0.05 %	MHV-2, MHV-N, CCV	7
Klorit Natriumi	0.23%	MHV-2, MHV-N, CCV	7
Formaladehide	0.70%	MHV-2, MHV-N, CCV	7

Neni 12

Qasjet e pastrimit

Përdorimi i hipokloritit të natriumit 0.1 % (Hollimi 1:50 nëse përdoret zbardhues shtëpiak në një përqëndrim fillestar prej 5%) pas pastrimit me një pastrues neutral sugjerohet për qëllime të dekontaminimit, megjithëse nuk ka të dhëna për efektivitetin e saj ndaj SARS CoV-2.

Për sipërfaqet që mund të dëmtohen nga hipokloriti i natriumit, përqëndrimi 70% i etanolit është i nevojshëm për ekontaminim pas pastrimit me një pastrues neutral.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën që i paraqitet për miratim Senatit Akademik.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

**RREGULLORE MBI MARRJEN E MASAVE HIGJENO-SANITARE
PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONEVE
RESPIRATORE AKUTE PËRFSHIRË DHE COVID – 19**

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-060-AL	06.05.2020	0	0	8 / 8

Neni 14**Zbatimi**

Zbatimi i kësaj rregulloreje garantohet nga Rektori i Kolegjit Universitar “Bedër” .

Neni 15**Dispozita kalimtare dhe të fundit**

Kjo rregullore është e vlefshme për të gjithë periudhën e pezullimit të procesit akademik në godinat e institucioneve të arsimit të lartë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati